



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI

Nr. 922/5 Prot.

Tiranë, më 08 . 07 . 2026

V E N D I M

Nr. 185, Datë 08 . 07 . 2026

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 121, datë 14.05.2026, paraqitur nga shtetasja M. K kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, me pretendimin për diskriminim për “*çdo shkak tjetër*¹”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Referuar ankesës së depozituar pranë KMD-së, subjekti ankues, M. K, pretendon se është diskriminuar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB).

Lidhur me pretendimin për diskriminim nga ana e DBP-së, subjekti ankues, ndër të tjera, shpjegon si më poshtë vijon:

Me Vendimin nr. 13-2019-279, datë 16.01.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, e shpalli shtetasen M. K, fajtores për veprën penale “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, duke e dënuar me 1 (një) vit burgim. Në zbatim të nenit 59, të Kodit Penal, Gjykata urdhëroi pezullimin e ekzekutimit të dënimit dhe vënien në provë për një periudhë prej 2 (dy) vjetësh me kusht.

Afati i vënies në provë, duke e llogaritur nga data e dhënies së vendimit, ka skaduar tërësisht. Asnjë revokim i vendimit të pezullimit nuk ka ndodhur gjatë kësaj periudhe. Në kushtet e kësaj situate

¹ Për shkak të mbajtjes të statusit “e dënuar” në gjendjen gjyqësore të saj, ndërkohë që konsiderohet e shuar ligjërisht.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD.

juridike, neni 59, paragrafi i fundit, i Kodit Penal është i qartë dhe i drejtpërdrejtë: “Kur vendimi i pezullimit nuk është revokuar, dënimi i dhënë konsiderohet i paqenë.”

Rrjedhimisht, në planin juridik, shtetasja M. K, ka status të personit pa precedent penal që nga rreth fillimi i vitit 2021.

Megjithatë, vërtetimi i gjendjes gjyqësore lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore), më datë 05.05.2026, vazhdon të regjistrojë të njëjtin dënim si aktiv, duke e mbajtur shtetasen M. K, padrejtësisht nën barrën e një statusi penal, të cilin ligji e ka shuar tashmë prej pesë vitesh.

Nëpërmjet shkresës dërguar zyrtarisht DPB-së, e interesuara ka paraqitur një kërkesë për veprim, me lëndë rehabilitimin ligjor të saj dhe pasqyrimin e saktë të statusit të saj gjyqësor në Regjistrin Gjyqësor.

Sipas historikut të gjurmimit postar, shkresa ka arritur dhe është dorëzuar në destinacion më datë 27.02.2026. Nga ajo datë e deri aktualisht, pasi ka kaluar një periudhë mbi 2 (dy) mujore, nga DPB, nuk është kthyer asnjë përgjigje, as pozitive, as negative, në tejkalim të çdo afati ligjor për kthimin e përgjigjes.

Mosveprimi i DPB-së nuk përbën thjesht një neglizhencë procedurale të rastit, pasi ai ka pasoja të drejtpërdrejta e të matshme për shtetasen M. K: një vërtetim i gjendjes gjyqësore, dokument i domosdoshëm për punësim, procedura administrative, udhëtime dhe raporte me institucione të ndryshme, vazhdon të prodhojë dhe të ligjërojë një pasqyrim të gabuar të realitetit juridik të saj.

Në ankesë parashtrohet se, këto mosveprime të DPB-së, në thelb përbëjnë trajtim të pabarabartë e diskriminues për këtë shtetase. Mbajtja e padrejtë e statusit “e dënuar” në gjendjen gjyqësore, ndërkohë që ligji e ka shpallur të shuar, e vendos shtetasen M. K në një pozicion juridik dhe social të ndryshëm e më të disfavorshëm, nga ai i personave të tjerë, të cilët, në të njëjtat kushte ligjore, kanë përfituar nga pasqyrimi i saktë dhe i plotë i rehabilitimit të tyre.

Subjekti ankues kërkon nga Komisioneri: “Shqyrtimin e ankesës në lidhje me trajtimin diskriminues nga DPB-ja, me qëllim verifikimin nëse mbetja e statusit penal pas shuarjes ligjore të dënimit, kombinuar me heshtjen administrative ndaj kërkesës zyrtare, përbën shkelje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.”

I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar³, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin

³ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 3, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të LMD-së, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Me shkresën nr. 922/2 prot., datë 28.05.2026, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, lidhur me pretendimet e ankueses.

Me shkresën nr. 9993/1 prot., datë 12.06.2026, DBP, ka dërguar parashtrimet dhe dokumentacionin e kërkuar nga Komisioneri⁴, duke theksuar faktin që, pas shqyrtimit të kërkesës nga Sektori i Gjendjes Gjyqësore, shtetases i është kthyer përgjigje shkresore nëpërmjet së cilës është kërkuar depozitimi pranë këtij sektori, i vendimit të Prokurorisë Elbasan për ekzekutimin dhe përfundimin e dënimit alternativ.

DPB, sqaron ndër të tjera se, për përditësimin dhe plotësimin e të dhënave në sistemin e gjendjes gjyqësore, është i domosdoshëm depozitimi i vendimit të Prokurorisë Elbasan që vërteton përfundimin e ekzekutimit të dënimit alternativ. Pas paraqitjes së këtij dokumenti, nga Sektori i Gjendjes Gjyqësore do të kryhen veprimet përkatëse për përditësimin e të dhënave në sistem. Ankuesja duhet të aplikojë përsëri në portalin e-Albania për t’u pajisur me Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore me shënimin “e padënuar”, pasi të jetë kryer përditësimi i të dhënave në sistem.

Subjekti ankues është njohur me parashtrimet dhe përgjigjen e mësipërme të DPB-së, pasi shkresa i është drejtuar/dërguar edhe asaj si palë e interesur drejtpërdrejtë, nga vetë DPB-ja.

II. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes

⁴ I cili është cituar dhe analizuar në pjesën e III-të të vendimit.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar pranë KMD-së, në një rend kronologjik të ngjarjeve, evidentohet se:

Me Vendimin penal nr. 13-2019-279, datë 16.01.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, shtetasja M. K është deklaruar fajtores për kryerjen e veprës penale “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” dhe është dënuar me 1 (një) vit burgim. Në zbatim të nenit 59, të Kodit Penal, ekzekutimi i dënimit është pezulluar dhe e dënuara është vënë në provë për një periudhë prej 2 (dy) vitesh.

Znj. M. K i është drejtuar DPB-së/Sektorit të Gjendjes Gjyqësore, më datë 27.02.2026, me kërkesë për rehabilitimin e vendimit penal nr. 13-2019-279, datë 16.01.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Pas shqyrtimit të kërkesës nga Sektori i Gjendjes Gjyqësore, shtetases i është kthyer përgjigje me shkresën nr. V-475/1 prot., datë 17.03.2026, nëpërmjet së cilës është kërkuar depozitimi pranë këtij sektori, i vendimit të Prokurorisë Elbasan për ekzekutimin dhe përfundimin e dënimit alternativ.

Shkresa në fjalë është dërguar me shërbim postar në adresën e deklaruar nga kërkuesja M. K. Megjithatë, më datë 24.03.2026, ajo është kthyer pranë DPB-së, nga Posta Shqiptare me shënimin “adresë e pasaktë”.

Gjatë kësaj periudhe, pranë institucionit DPB-së nuk rezulton që nga ankuesja të jetë depozituar dokumentacioni i kërkuar.

Ndërkohë, sipas të dhënave të sistemit VEGGJ⁵, shtetasja ka aplikuar online dhe, më datë 05.05.2026 është pajisur me Vërtetim të Gjendjes Gjyqësore me shënime, rrethanë e cila ka sjellë edhe paraqitjen e ankesës pranë KMD-së (më datë 14.05.2026).

Me shkresën nr. 938/1 prot., datë 29.05.2026, DPB, i ka kthyer përgjigje kërkesës së depozituar nga kjo shtetase mr nr. M-91/1 prot., datë 18.05.2026, ku i është kërkuar sërish depozitimi i vendimit për përfundimin e ekzekutimit të dënimit alternativ.

Nga ana e subjektit ankues pretendohet për mosveprim të DPB-së (cilësuar si heshtje administrative ndaj kërkesës së saj) dhe mbajtje të padrejtë e statusit “e dënuar” në gjendjen gjyqësore, ndërkohë që ligji e ka shpallur të shuar, gjë për të cilën shprehte se e ka vënë në kushtet e trajtimit të padrejtë e të pafavorshëm të saj.

Në analizë të kuadrit ligjor për sa më sipër, citojmë se:

⁵ Akronim, sipas citimit në shkresën me nr. 9993/1, datë 12.06.2026, të DPB-së.

Neni 69⁶ i Kodit Penal (Instituti i Rehabilitimit), përcakton se personat e dënuar me dënime më të lehta se 6 muaj burgim (ku futen shumica e dënimeve alternative si puna në interes publik apo pezullimi me kusht), quhen të padënuar nëse brenda 2 viteve nga dita e vuajtjes/përfundimit të dënimit nuk kanë kryer vepër tjetër penale.

Ligji për Ekzekutimin e Vendimeve Penale dhe Rregullorja për Sistemin e Gjendjes Gjyqësore, ngarkojnë Prokurorinë dhe Shërbimin e Provës me detyrimin për të përditësuar skedat penale pranë Ministrisë së Drejtësisë/Drejtorisë së Burgjeve menjëherë pas shuarjes apo përmbyshjes së dënimit.

Prokuroria është institucioni kryesor përgjegjës për vënien në lëvizje të ekzekutimit dhe njoftimin e çdo ndryshimi apo shuarjeje të dënimit pranë Zyrës së Gjendjes Gjyqësore.

Neni 481 i Kodit të Procedurës Penale - “Zyra e gjendjes gjyqësore”⁷, përcakton se pranë Ministrisë së Drejtësisë (Sektori i Gjendjes Gjyqësore) depozitohen vendimet për personat e gjykuar penalisht.

Neni 482 i Kodit të Procedurës Penale - “Shënimet në regjistrin gjyqësor”, specifikisht pikat b) dhe c), ngarkojnë organin e ekzekutimit (Prokurorinë) që të dërgojë për regjistrim çdo vendim të dhënë nga gjykata në fazën e ekzekutimit apo vendimet që lidhen me zbatim plotësues.

Neni 11⁸ i ligjit nr. 79/2020 “Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale”, përcakton se prokurori mban një dosje të veçantë për ekzekutimin e vendimit dhe kryen ose urdhëron të gjitha veprimet formale administrative për ndjekjen e dinamikës së dënimit deri në shuarjen e plotë të tij. Kur dënimi alternativ përfundon, prokurori nxjerr Urdhrin për Shuarjen e Ekzekutimit të Dënimit, të cilin ligjërisht ka detyrimin t’ia përcjellë Zyrës së Gjendjes Gjyqësore.

Shërbimi i Provës nuk komunikon gjithmonë direkt me Gjendjen Gjyqësore, por ka detyrimin ligjor të hartojë dhe dërgojë zyrtarisht dokumentin final të përmbyshjes së dënimit alternativ.

Neni 14 (ose nenet e Kreut për Mbikëqyrjen) të ligjit nr. 78/2020 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit të Provës”, ngarkon punonjësën e Shërbimit të Provës që në përfundim

⁶ Quhen të padënuar: a) ata që janë dënuar me burgim për një kohë gjer në gjashtë muaj ose me çdo dënim tjetër më të lehtë dhe që gjatë dy vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer vepër tjetër penale; b) ata që janë dënuar me burgim për një kohë nga gjashtë muaj gjer në pesë vjet dhe që gjatë pesë vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer vepër tjetër penale;

⁷ 1. Pranë Ministrisë së Drejtësisë, në zyrën e regjistrit gjyqësor, depozitohen shkurtime të vendimeve për personat e gjykuar penalisht. 2. Gjukata e shkallës së parë dërgon në zyrën e regjistrit gjyqësor shkurtime të vendimit të dënimit brenda 10 ditëve nga data që vendimi merr formë të prerë, kur ndaj tij nuk ushtrohet ankim dhe brenda 10 ditëve nga data e mbërritjes së akteve, kur ndaj vendimit është ushtruar ankim.

⁸ 1. Prokurori merr masa dhe vë në lëvizje procedurën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor penal dhe, në mbështetje të neneve 463 dhe 468 të Kodit të Procedurës Penale, procedon vetë ose urdhëron organet e tjera për vënien në ekzekutim të vendimit, sipas këtij ligji. 2. Prokurori mban dosje të veçantë për ekzekutimin e vendimit dhe për të gjitha aktet e administruara gjatë ekzekutimit.

të afatit të dënimit alternativ, të hartojë Raportin Përfundimtar për Përmbushjen e Kushteve të Provës.

Ky raport i dërgohet zyrtarisht Prokurorit të ekzekutimit dhe Gjykatës. Mbi bazën e këtij raporti të Shërbimit të Provës, Prokurori formulon urdhrin e mbylljes, i cili shërben si bazë për çregjistrimin e shënimit në kartotekën penale.

Duke analizuar sa më sipër, Komisioneri vëren se, veprimet e kryera nga ana e DPB-së lidhur me rastin e znj. K, janë në respektim të detyrimit ligjor dhe kompetencës që i ngarkon ligji dhe se nga ana e saj janë ndërmarrë të gjitha masat për sqarimin e shtetases se, nevojitej depozitimi i vendimit të Prokurorisë Elbasan për ekzekutimin dhe përfundimin e dënimit alternativ, pranë Sektorit të Gjendjes Gjyqësore.

Ankuesja është informuar se, pas paraqitjes së këtij dokumenti, nga Sektori i Gjendjes Gjyqësore do të kryhen veprimet përkatëse për përditësimin e të dhënave në sistem, duke e pajisur me Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore me shënimin “e padënuar”, pasi të jetë kryer përditësimi i të dhënave në sistem.

DPB ka shprehur vullnetin që nëse dokumenti i kërkuar do të tërhiqej dhe depozitohet pranë tyre dorazi, nga vetë ankuesja si person i interesuar drejtëpërdrejtë, do të vijonin me kryerjen e veprimeve të mëtejshme për përditësimin e të dhënave në sistem.

Për rrjedhojë, nisur nga veprimet e kryera nga ana e DPB-së, Komisioneri konstaton se nuk ka ndonjë shkelje ligjore apo parregullsi procedurale, nga ana e këtij Insitucioni, për pajisjen e shtetases M. K me Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore me shënimin “e padënuar”, në kushtet kur nuk është kryer përditësimi i të dhënave në sistem dhe një veprim i tillë nuk është në kompetencën e kësaj të fundit. Komisioneri vëren se, nuk DPB-ja nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi që i takojnë subjekteve të tjera.

Sa më sipër, mbështetur në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri vlerëson se, referuar provave të administruara nuk rezultoi se ankuesja është vendosur në pozita të pafavorshme apo të padrejta nga ana e DPB-së, sa i takon pajisjes me Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore me shënimin “e padënuar”.

Në mungesë të trajtimit të pafavorshëm e të padrejtë të subjektit ankues, bie poshtë edhe pretendimi për diskriminim, i cili në thelb do të duhet të kishte pikërisht konstatimin e trajtimit të pafavorshëm e të padrejtë të tij, të lidhur domosdoshmërisht me “shkakun” e pretenduar.

Komisioneri, vlerëson se për sa më sipër, nuk konstatohet se ka shkelje të ligjit 10221/2020 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, lidhur me veprimet e kryera për pajisjen e subjektit ankues me Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore.

Lidhur me pretendimin e ankueses për mos kthimin apo vonesën në kthimin e përgjigjes nga ana e DPB-së, Komisioneri vlerëson se, ky kërkim i znj. K, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin nga KMD, pasi ky kërkim ka të bëjë me moszbatimin apo shkeljet e dispozitave ligjore të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar, mbikëqyrja e të cilit është në fushën e kompetencave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, të shtetases M. K, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, lidhur me pajisjen e saj me Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)